



VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUGISHË
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

- Ac.nr. 821/18



Më 06.02.2019
Data: 06.02.2019

C.nr.902/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Ardian Ajvazi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditëses [redacted] nga fshati [redacted] Komuna Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati [redacted] nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Ferizaj-Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me kompensimin e tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse, vlera e objektit të kontestit 2.011,05 Euro, me datë 11.12.2017 merr këtë:

AKTGJYKIM

APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses [redacted] nga fshati [redacted] Komuna e Ferizajt dhe DETYROHET e paditura Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit që t'ia paguaj paditëses në emër të tri pagave përcjellëse në pension shumë prej 1,341.00 Euro dhe në emër të përvojës së punës mbi 40 vite në vlerë prej 150% të një page bazë dhe atë shumë prej 670.05, me kamatë prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij Aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 265.00, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas pranimit të të njejtit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Arsyetimi

Paditësja përmes të autorizuarit të tij me datë 13.10.2017, ka parashtruar padi, kundër të paditurës, lidhur kompensimin e tri pagave përcjellëse pas pensionimit dhe një page në vlerë prej 150% të pagës bazë.

I autorizuari i paditësit deklaroi se ngeli në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë se paditësja të e paditura ka qenë e punësuar në vendin e punës si mësimdhënëse klasore në shkollën fillore "Ismajl Qemajli" në fshatin Prelez, sipas kontratës së punës deri në ditën e pensionimit me datën 13.06.2017, kur është pensionuar për shkak të moshës 65 vjeçare. Se paditësja ka përvojë pune gjithsej 45 vite, dhe atë nga 21.09.1973 deri me 13.06.2017, paditësja ka paraqitur kërkesë për pagimin e një pagave jubilar dhe tri pagave për shkuarjen në pension, mirëpo e paditura një kërkesë të tillë e ka refuzuar me arsyetim se nuk ka mjete. Në bazë të kontratës kolektive të Ministrisë së Arsimit dhe atë të nenit 35.8 paditësja i takon një pagë jubilarë në vlerë prej 150 % dhe tri pagave përcjellëse në pension dhe atë në bazë të nenit 35.9 të kësaj kontrate kolektive e që është në aplikim nga data 18.04.2017, andaj i propozoj gjykatës që

Nga provat e elaboruar më lartë përkatësisht Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se paditësi ka përvojë të punës 45 vite dhe se dhe se i takon e drejta në realizimin e tri pagave përcjellëse pas pensionimit në shumën prej 1,341.00 Euro dhe në emër të përvojës së punës mbi 40 vite në vlerë prej 150% të një page bazë dhe atë shumën prej 670.05 Euro. Kjo është parapar në nenin 35 paragrafët 8 dhe 9 të Kontratës Kolektive të datës 18.04.2017.

Në bazë të Kontratës Kolektive të vitit 2017 paditësi realizon pas pensionimit tri paga përcjellëse në lartësinë e mesatarës së tri pagave të fundit e që është shuma e tërësishme prej 1,341.00 Euro (paga mesatare për tre muajt e fundit para pensionimit është 460.80 Euro), ndërsa shpërblimi jubilar për 40 vite e më shumë përvojë pune i takon e drejta për shpërblim jubilar në vlerë prej 150% të një page bazë. Paga bazë e paditësit është llogaritur ajo sipas kontratës së punës në shumën prej 447.34, ndërsa vlera e 150% të saj është 671.01 Euro, mirëpo paditësja ka kërkuar vlerën prej 670.05 dhe se Gjykata këtë vlerë ka aprovuar si të bazuar.

Pagat e shërbyesve civile, sektorit të arsimit, i shëndetësisë etj, financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe Komuna e Ferizajt është orgazatë buxhetore e nivelit lokal. Kontrata Kolektive e lidhur ndërmjet SBASHK dhe Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë (Qeveria e Republikës së Kosovës) prodhon efekt juridike nga data e lidhjes së saj 18.04.2017 dhe e paditura si organizat buxhetore e nivelit lokal është e detyruar t'ia paguaj paditësit shumat si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Gjykata sa i përket kamatës është bazuar në nenin 382.2 të LMD-së.

Nga faktet e treguara në padinë e paditësit si dhe nga provat dhe shkresat që gjenden në lëndë, rezulton si e bazuar kërkesëpadia e paditësit. Gjykata vërtetoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, e duke u bazuar në nenet 143 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.902/17 me datë 11.12.2017

Gjyqtari,
Ardian Ajvazi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.